A.K.P.A.
Nr 2917 Prot.
Datë,më 05.11.2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
SHKOLLA PROFESIONALE "BEQIR ÇELA" DURRËS

Nr.783 Prot.

Durrës, më 02.11.2026

Lënda : Njoftim për lëvizje paralele

Drejtuar: Drejtorisë Juridike dhe Burimeve Njerëzore,

Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun,

Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive.

Në zbatim të ligjit nr. 15/2019, "Për nxitjen e punësimit"; të ligjit nr. 15/2017, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë"; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 554, datë 31.7.2019, "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive"; të udhëzimit nr. 759, datë 30.09.2024, "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë,menaxhimin e burimëvë njerëzore,zhvillimin e vazhduar professional të përsonëlit,përbërjen e njësisë së zhvillimit.të institucioneve të ofruesve të arsimit dhe formimit profesional "I ndryshuar.

Ofruesi publik I AFP-së, Shkolla profesionale "Beqir Çela", ju njofton krijimin e vendit të lirë për pozicionin:

1. Instruktor të praktikës profesionale në drejtimin Sherbime mjetesh transporti– **1 (një) vend vakant (dalje në pension).**

1 - Kriteret e pergjithshme dhe kriteret e posaçme

Kriteret e pergjithshme:

Aplikanti për mësimdhënës të kulturës profesionale në ofruesit publik të arsimit dhe formimit profesional duhet të përmbushë këto kritere:

a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;

b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;

c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;

d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;

e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;

f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe të motivimit.

Kritere të posaçme

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme për instruktor të praktikës profesionale:

a) të ketë të paktën diplomë nga një shkollë e mesme profesionale,pas të mesme ose parauniversitare në të njëjtën fushë me njërin nga kualifikimet profesionale të ofruesit publik të AFP-së. .

b) të ketë të ketë të paktën 3 (tre) vjet përvojë pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet;

c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit.

2- Dokumentet e aplikimit

Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar, sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:

a) letërmotivimin për pozicionin;

b) jetëshkrimin (CV-në), sipas shtojcës 11 të këtij udhëzimi;

c) kartën e identitetit;

d) diplomën;

e) librezën e punës;

f) çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;

g) certifikatë ose dëshmi për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;

h) vërtetim të gjendjes shëndetësore;

i) vërtetim të gjendjes gjyqësore;

j) vërtetim nga punëdhënësit i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi;

k) të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënës të mëparshëm.

✓ *Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre.*

- ✓ *Dokumentet në gjuhën e huaj duhet të jenë të përkthyera në gjuhën shqipe dhe noterizuara.*

Dokumentet e aplikimit dorëzohen në zyrën e protokollit të ofruesit publik të AFP-së, brenda datës 12.11.2026

3. Vlerësimi i kandidatëve do bëhet referuar përcaktimeve të udhëzimit nr. 759, datë 30.09.2024, "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë, menaxhimin e burimeve njerëzore, përbërjen e njësisë së zhvillimit të institucioneve, ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit", i ndryshuar.

DREJTOR

Fatmir Merkuri